

VENDIM I
ORTAKUT TË VETËM
TË
“NOA ENERGY TRADE SHPK”

Sot, më datë 05.04.2023, unë i nënshkruari **Gentian Sula**, shtetas shqiptar, lindur më 09.03.1983, mbajtës i pasaportës me numër personal I30309064B, në cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë **Noa Energy Trade**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e organizuar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar në Regjistrin Tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit (“**QKB**”), me numër unik identifikimi të subjektit (**NUIS**): L42203031A dhe seli në adresën: “*Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Kullat Binjake, Kati 2, Tiranë, Shqipëri*” (në vijim referuar si “**Shoqëria**”),

MEQËNËSE:

- Unë jam ortak i vetëm i kuotës së Shoqërisë, e cila përfaqëson 100% të kapitalit të saj, me vlerën 431.293.021,00 (*katërqind e tridhjetë e një milion e dyqind e nëntëdhjetë e tre mijë e njëzet e një*) Lekë;
- Dëshiroj që të transferoj kuotën time të zotëruar në Shoqëri, si kontribut i vlerësuar në para tek shoqëria Noa Holding Sh.p.k. me **NUIS: M31509039J**.

Për sa më sipër, në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*”, të ndryshuar, vendosa si vijon:

VENDOS:

1. Të transferoj kuotën time në Shoqëri, e cila përfaqëson 100% të kapitalit të Shoqërisë, me vlerën 431.293.021,00 (*katërqind e tridhjetë e një milion e dyqind e nëntëdhjetë e tre mijë e njëzet e një*) Lekë, në formën e kontributit të vlerësuar në para në shoqërinë Noa Holding Sh.p.k. me **NUIS: M31509039J**.
 - Kuota do të përfshihet në formën e kontributit të vlerësuar në para në kapitalin e shoqërisë Noa Holding Sh.p.k., në përputhje me vlerën e saj nominale, siç gjendet aktualisht e regjistruar në Regjistrin Tregtar të mbajtur nga QKB. Si pasojë e këtij kontributi, ortaku i vetëm i Shoqërisë, do të jetë shoqëria Noa Holding Sh.p.k.
2. Në përputhje me sa më sipër, ndryshohet neni 8 i statutit të Shoqërisë, si vijon:

“Neni 8

Kapitali themeltar

- 8.1 *Kapitali themeltar i Shoqërisë është 431.293.021,00 (katërqind e tridhjetë e një milion e dyqind e nëntëdhjetë e tre mijë e njëzet e një);*

- 8.2 *Kapitali i Shoqërisë do të ndahet në 1 (një) kuotë, me vlerën 431.293.021,00 (katërqind e tridhjetë e një milion e dyqind e nëntëdhjetë e tre mijë e njëzet e një);*
- 8.3 *Kuota e kapitalit zotërohet 100% nga ortaku i vetëm, Shoqëria Noa Holding Sh.p.k.”*
3. Të depozitohet këtë vendim si dhe çdo dokument tjetër të nevojshëm pranë QKB dhe pranë të gjitha autoriteteve ku ky depozitim është i nevojshëm

ORTAKU I VETËM
GENTIAN SULA

